

Martesa me detyrim dhe rrethprerja e organit gjenital të femrës

Martesa me detyrim (Zwangsheirat) dhe rrethprerja e organit gjenital të femrës (Mädchenbeschneidung) janë të ndaluara në Zvicër. Përveç qendrave të specializuara, mbështetje ofron edhe organizata Ndihma për viktimat.

Çfarë është martesa me detyrim?

Nëse një person martohet nën presionin e familjes dhe kundër dëshirës së vet, atëherë kjo quhet martesë me detyrim. Martesa mund të shpallet e pavlefshme. Njerëzit gjithashtu janë të lirë të zgjedhin, nëse duan të vazhdojnë martesën apo dëshirojnë të ndahen. Nëse ata e vazhdojnë martesën kundër dëshirës së tyre, kjo quhet martesë me detyrim.

Shembuj të detyrimit janë: Kërcënimet, shantazhet, presionet psikike apo dhuna fizike. Lidhje martesash me detyrim dhe martesa të detyruara janë të ndaluara në Zvicër.

Ndihma

Zyra kombëtare e specializuar për martesat me detyrim zwangsheirat.ch këshillon personat e prekur dhe specialistët në mënyrë konfidenciale dhe falas: Linja e ndihmës 0800 800 007 / info@zwangsheirat.ch

Çfarë është rrethprerja e organit gjenital të femrës?

Në rrethprerjen e organit gjenital të femrës, organet gjenitale të femrës rrethpriten. Ka forma dhe praktika të ndryshme. Shumë vajza dhe gra, të cilat kanë kaluar këtë gjë, vuajnë fizikisht dhe shpirtërisht nga pasojat e rrethprerjes.

Rrethprerja e organit gjenital të femrës është e ndaluar. Prindërit gjithashtu i nënshtrohen ndjekjes penale, nëse organizojnë rrethprerjen e organit gjenital të fëmijës së tyre jashtë Zvicrës.

Ndihma

Rrjeti kundër rrethprerjes së organit gjenital të femrës ofron informacione dhe krijon lidhje me njerëz të rëndësishëm. Shoqata Caritas Zvicër këshillon familje të prekura falas dhe në mënyrë konfidenciale: 042 419 23 55 /

beratung@maedchenbeschneidung.ch

Edhe organizata Ndihma për viktimat (Opferhilfe) mund të ofrojë mbështetje.



Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/dhuna-ne-familje/martesa-me-detyrim-dhe-rrethprerja-e-organit-gjenital-te-femres